



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



PROJEKTBUXHETI ***2025-2027***

FERIZAJ

PËRMBAJTJA

Misioni dhe qëllimi	3
Përkufizimi i termeve	4
Përmbledhje	5
Procesi i hartimit të projekt buxhetit 2025-2027	6
Struktura e financimit buxhetor	7
Struktura buxhetore me burim financimi dhe krahasimi 2025/2024	8
Synimet e qeverisë lokale në kuadër të planifikimit buxhetor	9
Kufijtë e financimit	10
Burimet e financimit	10
Përcaktimi i prioriteteve	12
Ndikimi i buxhetit krahas problemeve të Komunës	12
Shpërndarja buxhetore në kategori ekonomike	13
Shpërndarja e buxhetit në programe buxhetore	18
Tabela I - Të hyrat dhe shpenzimet komunale.....	19
Tabela II - Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal.	20
Tabela III - Plani i ndarjeve buxhetore.....	21
Tabela IV - Plani Afatmesëm 2025-2027 për investime kapitale.....	27
Tabela V - Financimi i projekteve sipas burimeve të financimit.....	34

Misioni dhe qëllimi

Deklarata e misionit : Komuna e Ferizajt është njësi themelore territoriale administrative e Republikës së Kosovës në të cilën qytetarët e saj realizojnë të drejtat e tyre në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikuara. Në bazë të kësaj, Komuna është e obliguar dhe përgjegjëse për realizimin e kërkesave të qytetarëve në të gjitha fushat në mënyrë që të ndërtoj dhe ngris mirëqenien e tyre, duke ofruar shërbime efikase, si dhe investime në infrastrukturën e përgjithshme. Përmes Kuvendit si organ legjislativ, miraton një sërë vendimesh për rregullimin e infrastrukturës si të asaj ligjore (vendime, miratimit të rregulloreve, strategjive etj) ashtu edhe asaj ekonomike e sociale. Përmes Kryetarit të Komunës, përkujdeset për realizimin e të gjitha vendimeve nga të gjitha lëmitë, grumbullon taksat dhe ngarkesat administrative nga qytetarët për të financuar më pas projektet që janë në të mirën e përgjithshme.

Qëllimi i misionit: Rritja e efikasitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, respektim i standardeve ligjore e procedurale në shërbimet administrative. Programi i qeverisjes lokale do të fokusohet në mënyrë të veçantë, që të ofroj qytetarëve shërbime administrative cilësore si dhe në avancimin e mëtejshëm të përdorimit të teknologjisë informative, nëpërmjet procesit të digjitalizimit të të gjitha shërbimeve administrative, në të gjitha fushat. Administrata synon të siguroj të gjitha shërbimet administrative efikase përmes Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunës sonë. Kryetari i Komunës menaxhon buxhetin e Komunës të miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe ai i Republikës së Kosovës, në përputhje të plotë me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe të Ligjit mbi Financat Lokale, gjithashtu realizimin e interesave të qytetarëve përmes departamenteve përkatëse komunale.

PËRKUFIZIMI I TERMEVE

(përkufizimi i termeve që përdoren në këtë dokument)

Paga dhe Shtesa- Mjetet e parapara për pagesën e pagave të rregullta të punëtorëve që gjenden në listën e rregullt të pagave, pagesat për mëditjet e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pagesat për mjekët të cilët realizojnë kujdestari në shëndetësi si dhe pagesat e ndryshme për stimulime dhe mëditjet e udhëtimeve zyrtare.

Mallra dhe Shërbime- Mjetet e parapara për blerje të ndryshme siç janë furnizimet me material zyre, furnizime me pajisje, furnizime me derivate etj. Kryerje të shërbimeve të ndryshme siç janë shërbimet kontraktuese, mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve si dhe shpenzime të cilët janë të nevojshme për realizimin e detyrave dhe obligimeve të drejtorive përkatëse komunale.

Komunali- Kategori ku janë të përfshira pozicionet e kategorisë ekonomike të shpenzimeve siç janë: shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mbeturinave, shpenzimet e telefonisë dhe shpenzimet tjera komunale publike.

Subvencionet dhe transferet- Kjo kategori ekonomike përfshinë shpenzimet e parapara për ndihmapër raste të ndryshme sociale, ndihma për familjet e Dëshmorëve, fëmijët bonjak, si dhe të tjerë, bursa për studentë, si dhe participimet në kulturë, rini dhe sport.

Investime kapitale- Kjo kategoritë ka të bëjë me investimet e ndryshme kapitale në infrastrukturë si: rregullimi i rrugëve, sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit, ndërtimi i objekteve të ndryshme si shkollat, pastaj ndërtesave shëndetësore, parqeve etj.

Të Hyrat Vetanake- Ka të bëjë me grumbullimin e të hyrave që janë të parapara me Udhëzime Administrative(UA) dhe Rregulloren Komunale mbi të hyrat vetanake. Këtu kemi të bëjmë me Tatimin në Pronë, taksat e biznesit, të hyrat nga shërbimet gjeodezike, shërbimet e urbanizimit, të hyrat nga dhënia e pronës komunale me qira si dhe të hyrat tjera administrative.

Granti Qeveritar- Ka të bëjë me mjetet e ndara nga Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK).

Shërbimet e kontraktuara;- Ka të bëjë me disa kategori të shpenzimeve që realizohen me kontrata që nuk kanë të bëjnë me furnizime por janë kategori të shërbimeve të ndryshme.

Furnizimet e tjera;-Furnizimet të cilat nuk i takojnë furnizimeve që parashihen me pozicione ekonomike të rregullta. Si të tilla, ato paraqesin raste të veçanta.

UA – Udhëzim Administrativ

MFPT – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

BKK – Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

KK Ferizaj – Kuvendi i Komunës së Ferizajt

KPF – Komiteti për Politikë dhe Financa

PIP – Programi i Investimeve Publike

TI- Teknologjia Informativë

PËRMBLEDHJE

Buxheti i vitit 2025 është hartuar në harmoni me KASH-in e Qeverisë dhe është ndërtuar në përputhje me procedurat e parashikuara buxhetore 2025/2027, të dhëna nga MFPT përmes Qarkores Buxhetore 2025/01 dhe Qarkores Buxhetore 2025/02. Korniza Afatmesme Buxhetore si dokument strategjik siguroi një analizë të hollësishme të shpenzimeve komunale duke aplikuar qasje shumëvjeçare, duke përcaktuar parametrat si dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e procesit të buxhetit vjetor, mbi bazën e së cilit ne zhvilluam procesin e projektbuxhetit për vitet 2025-2027. Duhet theksuar se për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm të komunës sonë, shfrytëzimi i mundësive dhe potenciali zhvillimor i saj, nuk është në nivelin e duhur për faktin se një potencial i tillë natyror i disponueshëm kërkon nivel shumë më të lartë buxhetor. Në këtë drejtim gjetja e investitorëve të brendshëm e të jashtëm, në të ardhmen do të ndikoj në mënyrë të ndjeshme për kompensimin e mungesës së mjeteve buxhetore duke ndërtuar marrëdhënie partneriteti me sektorin privat për të financuar projektet e mëdha kapitale dhe projekte të tjera, të cilat nuk do të mund të financoheshin nga mjetet e Komunës në mungesë të buxhetit.

Qeveria lokale synon që të funksionalizoj zonat ekonomike të krijuara nga procesi i dhënies së tokës në shfrytëzim, duke investuar në infrastrukturën e tyre: rrugët, sistemin e infrastrukturës nëntokësore, sistemin elektrik, sistemin e sigurisë, etj., si dhe krijimin e zonave të reja ekonomike nga ana e komunës, të kompletuara në aspektin infrastrukturor, me rezultate të pritshëm: krijimin e bizneseve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese, gjithnjë në funksion të rritjes së punësimit dhe të ardhurave. Po ashtu është në proces edhe dhënia e tokës në shfrytëzim të Komunës duke u mbështetur në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës Komunale, për të interesuarit, afaristët të cilët aplikojnë me projekte atraktive (investitorët), ku prioritet është përcaktuar t'i jepet veprimtarisë prodhuese dhe me këtë ndërmarrje administrata jonë tenton që të rris numrin e të punësuarve e në të njëjtën kohë ngritjen e trendit pozitiv në fushën e zhvillimit ekonomik të komunës sonë. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik do të lehtësoj përpjekjet e qeverisë lokale e konkretisht Kryetarit të Komunës, për rritjen e vlerës buxhetore përmes gjetjes së burimeve të ndryshme të financimit si nga donatorët e jashtëm ashtu edhe ata të brendshëm.

Procesi i hartimit të Projekt-Buxhetit 2025-2027

Mbështetur në rëndësinë jetike që ka buxheti si ligj për të materializuar dhe ngritur mirëqenien e qytetarëve, institucionet qendrore të shtetit kanë ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për të proceduar dhe zhvilluar procesin e hartimit të buxhetit për të gjitha institucionet përfshirë edhe komunat duke iu shpërndarë qarkoret buxhetore si dokumente bazë dhe të cilat përmbajnë instruksionet e nevojshme për finalizimin e procesit si tërësi.

Procesi i hartimit të projektbuxhetit me të drejtë konsiderohet si njëri ndër proceset më të rëndësishme për një organizatë buxhetore, për faktin se nga ai proces hartohet buxheti si një ligj i cili përmban planin e financimit të funksioneve dhe detyrimeve të shtetit.

Organizata jonë buxhetore (656) ka zhvilluar procesin e hartimit të buxhetit për vitet 2025-2027, në harmoni të plotë me instruksionet e pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Qarkoreve Buxhetore 2025/01 dhe 2025/02, në harmoni me caqet e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025/2027 (KAB) si dhe në zbatim të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi i tij të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të komunës sonë, për aq sa edhe kanë lejuar kufijtë e limituar të financimit. Projektbuxheti përpos burimeve të financimit apo burimeve të bërjes së tij, përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale të shpërndara në pesë kategori ekonomike të shpenzimeve si dhe njëmbëdhjetë programe buxhetore.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka hartuar qarkoret buxhetore bazuar në të dhënatë përcaktuara nga Komisioni i Granteve, i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara si numri i popullsisë, numri i nxënësve, numrin i pakicave kombëtare etj. Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për **vitin 2025** do të ketë vlerën **46,013,006.00 €**.

Struktura e financimit buxhetor

Struktura e financimit buxhetor të komunës përbëhet prej dy burimeve të financimit dhe atë:

1. Granti qeveritar:

Granti i përgjithshëm;
Granti specifik i arsimit;
Granti specifik i shëndetësisë;
Granti shtesë për Qendrës Rezidenciale;
Granti për Teatër.

2. Të hyrat vetanake

Struktura e financimit		
Përshkrimi	Viti 2025	Pjesëmarrja në %
Granti i Përgjithshëm	17,463,074.00	37.95
Granti Specifik i Arsimit	15,604,654.00	33.91
Granti Specifik i Shëndetësisë	4,515,368.00	9.81
Financimi për QR	200,000.00	0.43
Financimi për teatro	255,604.00	0.56
Të hyrat vetanake	7,974,306.00	17.33
Totali	46,013,006.00	100.00

Tabela 1 Burimet e financimit

Buxheti i vitit 2025 karakterizohet me rritje të vlerës buxhetore. Të hyrat vetanake janë rritur në krahasim me vitin 2024. Mbështetur në totalin e buxhetit për vitin 2025 të aprovuar nga MFPT vërehet se kemi rritje të vlerës buxhetore krahasuar me vitin 2024 për 11.73%% kjo rritje është e ndikuar nga rritja e vlerës së Grantit të përgjithshëm, Grantit specifik të shëndetësisë, Grantit shtesë të Qendrës Rezidenciale.

Përshkrimi	Buxheti i vitit 2024	Buxheti i vitit 2025	Krahasimi në vlerë	Krahasimi në %
Buxheti	41,184,014.00	46,013,006.00	4,828,992.00	11.73%

Tabela 2. Krahasimi i buxhetit 2024/2025

Struktura buxhetore me burim financimi dhe krahasimi 2024/2025

Burimin e financimit të projekt-buxhetit për vitin 2025 e karakterizon rritja e vlerës së grantit qeveritar nga 35,774,286.00€ sa është në vitin 2024 në 388,038,700€ apo në përqindje është 11.73% pra është më i lartë krahasuar me vlerën e vitit 2024. Të hyrat vetanake janë rritur dhe për vitin 2025 janë 7,974,306.00€ në krahasim me vitin 2024 që ishin në vlerë 5,409,728.00€ shprehur në përqindje janë 47.41%. Tani buxheti i komunës sonë do të pësoj ndryshime duke u rritur krahasuar me buxhetin e vitit paraprak për 11.73 %, pra nga 41,184,014.00€ sa ishte për vitin 2024, në 46,013,006.00 për vitin 2025.

Përshkrimi	Viti 2024	Të dhënat nga qarkorja e parë	Krahasimi 2024-2025 në vlerë	Krahasimi 2024/2025 në %
	Buxheti aktual	2025/01		
Granti i përgjithshëm	16,154,546.00	17,463,074.00	1,308,528.00	8.10%
Granti specifik i Arsimit	14,823,735.00	15,604,654.00	780,919.00	5.27%
Granti specifik i Shëndetësisë	4,372,663.00	4,515,368.00	142,705.00	3.26%
Financimi për QR	179,096.00	200,000.00	20,904.00	11.67%
Financimi për teatro	244,246.00	255,604.00	11,358.00	4.65%
Të hyrat vetanake	5,409,728.00	7,974,306.00	2,564,578.00	47.41%
Totali	41,184,014.00	46,013,006.00	4,828,992.00	11.73%

Synimet e qeverisë lokale në kuadër të planifikimit buxhetor

Edhe përkundër synimit të qeverisë lokale që është në kuadër të strukturës buxhetore që të shënojmë ngritje të vlerës së kategorisë së investimeve kapitale si dhe zvogëlimin e shpenzimeve të përfshira në kategorinë mallra dhe shërbime, duke u bazuar në kufijtë e kategorive ekonomike të dhënë në qarkoren e dytë vërehet se kemi ulje të vlerës së investimeve kapitale, rritje për kategorinë mallra dhe shërbime, ulje për kategorinë e shpenzimeve komunale apo komunalive , rritje për kategorinë paga dhe mëditje ndërsa ulje të subvencioneve. Duke pasur parasysh se kufijtë buxhetor nuk lejojnë tejkalim të vlerave në kategoritë ekonomike ne duhet t'iu përmbahemi këtyre kufijve buxhetor sipas qarkores 2025/02.

Duhet konstatuar se buxheti nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e qytetarëve të komunës sonë në tërësi si dhe duhet ngritur në nivelin e dëshiruar trendin e zhvillimit ekonomik, mirëpo e rëndësishme është që këto mjete që do të kemi në disponim gjatë vitit fiskal 2025 t'i shfrytëzojmë me efikasitet të plotë, në përputhshmëri me prioritetet e përcaktuara si dhe në harmoni me infrastrukturën ligjore e cila rregullon fushën e shpenzimeve të parasë publike.

Qarkoret buxhetore 2025/01 dhe 2025/02 përpos instruksioneve, kufijve buxhetor të financimit kërkojnë gjithashtu respektimin e afateve kohore për miratim të Projektbuxhetit të vitit 2025, pastaj Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Ligji i Financave Lokale.

Qarkorja 2025/01 si dhe ajo 2025/02 ju ka shpërndarë të gjitha drejtorive përmes qarkoreve buxhetore, drejtoritë apo programet janë të njoftuara lidhur me procedurat e përpilimit të projektbuxhetit, për afatet kohore, kufijtë e financimit si dhe për çështjet tjera.

Buxheti i komunës është i shpërndarë në programe buxhetore ku çdo drejtori është program në vete me të gjitha të drejtat dhe obligimet që janë të parapara me ligj. Drejtorët e Drejtorive janë autorizues të shpenzimit të buxhetit të tyre.

Në kuadër të limiteve përcaktuese kemi edhe ato mbi numrin e të punësuarve i cili duhet të jetë për miratim në shifër 2459 për vitin 2025.

Kufijtë e financimit

Nr.	Kategoria	Kufiri i përcaktuar me qarkoren buxhetore 2025/2	Kërkesa e organizatës buxhetore	Ndryshimi
	Stafi	2459	2459	0
		FB GQ,	FB GQ	
1	Paga dhe mëditje	20,913,354.31	21,140,016.31	(226,662.00)
		FB GQ, THV	FB GQ, THV	
2	Mallra dhe shërbime	8,267,928.69	10,001,123.37	0
		1,733,194.68		
		FB GQ	FB GQ,	
3	Komunali	719,694.00	719,694.00	0
		FB GQ, FB THV	FB GQ, FB THV	
4	Subvencione	37,746.00	2,050,000.00	0
		2,012,254.00		
		FB GQ, THV	FB GQ, THV	
5	Shpenzime kapitale	10,192,247.33	12,102,172.32	226,662.00
		2,136,586.99		
		FB GQ, FB THV	FB GQ, FB THV	
6	Totali i buxhetit	46,013,006.00	46,013,006.00	0

Burimet e financimit

Buxheti i vitit 2025 është i financuar nga dy burime: Granti qeveritar dhe Të hyrat vetanake.

GRANTI QEVERTAR -Buxheti i paraparë nga granti qeveritar është burim kryesor i buxhetit të Komunës së bashku me të hyrat vetanake. Mjetet e ndara nga ky grant i cili financon buxhetin me **82.67%**

bazohet në disakritere për caktimin e vlerës së grantit.

Kriteret për përcaktimin e grantit të përgjithshëm janë “numri i popullsisë”, ku për komunën tonë numri i marr për bazë nga komisioni i granteve është prej 108.631 banorë, numër i dalur me regjistrimin e fundit të popullsisë e që Komunën e Ferizajt e rangon në vendin e tretë me numër të banorëve.

Kritere tjera për përcaktimin e grantit të përgjithshëm janë edhe: gjërësia gjeografike, pakicat kombëtare etj. Ndërsa për grantin specifik të arsimit si dhe të shëndetësisë kemi përcaktime tjera të kritereve siç është: numri i nxënësve pastaj hapësira shkollore, vizitat për kokë banori etj. Në kuadër të grantit qeveritar për vitin 2025, komisioni i granteve ka përcaktuar këtë vlerë 38,038,700.00€.

TË HYRAT VETANAKE: Burim i dytë i financimit të projektbuxhetit, të hyrat vetanake marrin pjesë me 17.33% të përbërjes së buxhetit përmes planifikimit të tyre në bazë vjetore sipas zërave të të hyrave. Sipas qarkores buxhetore dhe kufijve përcaktues planifikimi i të hyrave në vlerë 7,974,306.00 për vitin 2025, do të jetë më i lartë në vlerë se planifikimi i vitit 2024.

Të hyrat nga Administrata Komunale: Një ndër burimet shumë të rëndësishme të financimit të buxhetit të komunës sonë është grumbullimi i të hyrave vetanake. Grumbullimi i të hyrave vetanake bazohet në rregulloren e komunës mbi tarifatat dhe ngarkesat komunale si dhe në rregulloren e tatimit në pronë.

Parësore në kuadër të të hyrave vetanake është Tatimi në Pronë, që njëherit është i vetmi tatim që ka të drejtë Komuna ta grumbulloj. Synim i qeverisë lokale është, padyshim rritja e efikasitetit dhe performancës në realizimin e të hyrave vetanake, në fokus inkasimi i tatimit në pronë, i cili do të mundësoj padyshim ngritjen e vlerës buxhetore të kategorisë së investimeve kapitale për të ngritur kështu trendin e mirëqenies sociale për qytetarët e komunës sonë.

Të hyrat nga arsimi: Janë të hyra që vijnë kryesisht nga participimi i qytetarëve për shërbimet që kryhen nëçerdhen e fëmijëve, si dhe mësimi i pershpejtuar. Por kemi edhe të hyra të arsimit nga objektet e dhëna me qira në disa shkolla, si dhe pagesat e ndryshme për marrjen e çertifikatave shkollore. Këto mjete buxhetore janë planifikuar kryesisht në Drejtorinë e Arsimit në kategorinë mallra dhe shërbime.

Të hyrat nga shëndetësia: Janë ato të hyra që kanë të bëjnë me participimet shëndetësore që duhet të participojnë qytetarët e të cilat mjete do të planifikohen për të rritur efikasitetin e shërbimeve mjekësore në sektorin e shëndetësisë primare. Pasi që me UA të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë një pjesë të madhe të kategorive të qytetarëve e liron nga obligimi i pagesës së shërbimeve shëndetësore në të ardhmen do të ketë një grumbullim më të vogël të të hyrave vetanake shëndetësore.

Projekt-Buxheti i vitit 2025		
Burimi i financimit	Viti 2025	Pjesëmarrja në përqindje
Granti qeveritar	38,038,700.00	82.67
Të hyrat vetanake	7,974,306.00	17.33
Totali	46,013,006.00	100.00%

Tabela 4. Pjesëmarrja e burimeve të financimit

PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE

Njëri ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është ai i përcaktimit të prioriteteve të përgjithshme zhvillimore. Vendosja e prioriteteve kërkon analizë dhe angazhim të qeverisë lokale së pari të identifikoj nevojat zhvillimore, pra është një segment tejet i rëndësishëm në kuadër të procesit buxhetor, andaj pikërisht për shkak të kësaj rëndësie që ka, Kryetari i Komunës i kushton shumë kujdes. Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë nevojat e qytetarëve të komunës sonë, si dhe planifikimet zhvillimore të qeverisë lokale, të cilat janë në funksion të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve të Komunes sonë. Mbi bazën e këtyre nevojave Kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij si dhe në konsultim me qytetarët e në varësi me mjetet e disponueshme ka përcaktuar prioritetet 2025-2027 e me fokus ato të vitit fiskal 2025. Kriter shumë i rëndësishëm është edhe identifikimi i nevojave duke parë gjendjen aktuale në terren si në atë urbane ashtu edhe në atë rurale sa i përket investimeve në projektet infrastrukturore.

NDIKIMI I BUXHETIT KRAHAS PROBLEMEVE TË KOMUNËS

Organizata jonë buxhetore ka të identifikuar nevojat për zhvillim të gjithëmbarshtëm por që janë në disproporcion me mundësitë buxhetore. Edhe buxheti i vitit fiskal 2025 do të ndikoj në masë të konsideruar në zhvillimin e komunës sonë në të gjitha sferat por se assesi edhe pse ka shënuar ngritje nuk do të mund të përmbush kërkesat e përgjithshme qytetare. Në këtë drejtim absorbimi i granteve të donatorëve qofshin ato të brendshme apo të jashtme do të ndikoj pozitivisht në ngritjen e trendit në realizimin e kërkesave zhvillimore e sociale. Pra, vlera e limituar e buxhetit për vitin 2025 nuk jep hapësirë dhe mundësi për një ndikim të theksuar në fushën e zhvillimit ekonomik të komunës sonë. Mirëpo investimet e shumta që bëhen në infrastrukturë rrugore si dhe futja në projektbuxhet të projekteve si ai i subvencionimit të bizneseve padyshim se reflektojnë në mënyrë indirekte dhe direkte në zhvillimin ekonomik të komunës sonë, pastaj rritja e përkrahjes së sektorit të bujqësisë, duke hartuar politika subvencionuese për lëmitë e saj, janë indikator të përkushtimit institucional për të ndihmuar zhvillimin e kapaciteteve të bizneseve tona, në funksion të zhvillimit të tyre dhe të gjenerimit të vendeve të reja të punes. Ashtu siç potencuam edhe më lartë zgjerimi i infrastrukturës ligjore apo pasurimi edhe më tej me ligje të cilat hapin rrugë për zhvillimin e marrëdhënieve në mes institucioneve publike dhe sektorit privat për të mirën e përgjithshme (Ligji i Partneritetit Publiko-Privat dhe Koncesionet) do të zvogëlojnë mungesën buxhetore të organizates sonë për ndërtimin e një mirëqenie më të mirë për qytetarët e komunës sonë.

SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË KATEGORI EKONOMIKE

Shpenzimet për këtë kategori ekonomike janë bazuar kryesisht në plotësimin e nevojave më të domosdoshme për realizimin e detyrave dhe obligimeve që rrjedhin nga obligimet e programeve të caktuara. Në kategoritë ekonomike janë të paraqitura kërkesat për mjete që do të shpenzohen për mallra dhe shërbime. Pozicioni ekonomik shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me formimin e komisioneve të ndryshme të cilat duhet të kompensohen, kontratat e ndryshme në lidhje me realizimin e punëve si të sigurimit të objekteve, pastrimi i këtyre objekteve, transporti i nxënësve në shkollat speciale për persona me nevoja të veçanta. Heqja e shpenzimeve të varrimit si dhe mirëmbajtja e varrezave, mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore përfshirë mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtja e rrugëve me zhavor, vendosja dhe mirëmbajtja e shenjave të komunikacionit. Pozicionet tjera ekonomike të paraqitura në kategoritë ekonomike, nga emërtimi i tyre edhe kuptohet qëllimi i shpenzimit. Struktura buxhetore përmban pesë kategori ekonomike përmes së cilave organizata buxhetore realizon projeksionet e saj institucionale në shërbim të qytetarëve.

Kategoritë ekonomike janë: Paga dhe Shtesa, Mallra dhe shërbime, Shpenzimet komunale, Subvencione dhe Shpenzimet kapitale.

Kategoria ekonomike	Buxheti i vitit 2025	Pjesëmarrja në %
Pagat dhe mëditjet	20,913,354.31	45.45
Mallrat dhe Shërbimet	10,001,123.37	21.74
Shpenzimet komunale	719,694.00	1.56
Subvencionet	2,050,000.00	4.46
Shpenzimet kapitale	12,328,834.32	26.79
TOTALI	46,013,006.00	100.00

Kategoria “Paga dhe mëditje” për vitin 2025 ka rritje prej 2.86% krahasuar me vitin 2024, pjesëmarrja në totalin e buxhetit për vitin 2025 është 45.45%. Ne i jemi përmbajtur kufirit sipas qarkores 2025/02, ku numri i të punësuarve (Stafi) është 2459 për vitin 2025.

Kodi ekonomik	Kategoritë ekonomike	Buxheti aktual 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%
11100	Paga dhe mëditje	20,332,804.00	20,913,354.31	580,550.31	2.86%

Kategoria “Mallra dhe Shërbime” për vitin 2025 shënon rritje për 25.01%, krahasuar me vlerën e kësaj kategorie të vitit 2024. Ky planifikim është paraqitur në mënyrë krahasimore për të gjitha nënkategoritë ekonomike të përfshira në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime. Shpenzimet për këtë kategori ekonomike janë bazuar kryesisht në plotësimin e nevojave më të domosdoshme për realizimin e detyrave dhe obligimeve në kuadrin e programeve buxhetore.

Kodi ekonomik	Kategoritë Ekonomike	Buxheti aktual 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%
13000	Mallra dhe Shërbime	8,000,000.00	10,001,123.37	2,001,123.37	25.01%
1310	SHPENZIMET E UDHËTIMIT	34,537.46	33,005.88	-1,531.58	-4.43%
13130	Transporti për udhëtime zyrtare brenda vendit	5,084.45	6,359.63	1,275.18	25.08%

13132	Akomodimi për udhëtimet zyrtare brenda vendit	0.00	5,000.00	5,000.00	-
13140	Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit	6,884.31	8,606.35	1,722.04	25.01%
13141	Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	12,064.10	2,000.00	-10,064.10	-83.42%
13142	Akomodimi për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	4,073.40	3,000.00	-1,073.40	-26.35%
13143	Shpenzimet e tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	6,431.20	8,039.90	1,608.70	25.01%
1330	SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT	83,759.31	75,000.00	-8,759.31	-10.46%
13310	Interneti	11,455.06	10,000.00	-1,455.06	-12.70%
13320	Telefonia mobile	18,511.59	30,000.00	11,488.41	62.06%
13330	Shërbimet postare	53,792.66	35,000.00	-18,792.66	-34.94%
1340	SHPENZIMET PËR SHËRBIME	2,679,199.05	3,351,301.80	672,102.75	25.09%
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	20,614.72	25,771.28	5,156.56	25.01%
13430	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	5,073.40	3,000.00	-2,073.40	-40.87%
13440	Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale	339,635.18	200,000.00	-139,635.18	-41.11%
13445	Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	0.00	200,000.00	200,000.00	-
13450	Shërbimet e shtypjes/printimit	87,890.00	109,874.80	21,984.80	25.01%
13460	Shërbimet kontraktuese të tjera	1,803,901.03	2,147,655.72	343,754.69	19.06%
13470	Shërbimet teknike	17,800.02	5,000.00	-12,800.02	-71.91%
13475	Sigurimi fizik i objekteve publike	0.00	600,000.00	600,000.00	-
13480	Shpenzimet e anëtarësimit	20,614.70	60,000.00	39,385.30	191.05%
13490	Shërbimet e varrimit	383,670.00	0.00	-383,670.00	-100.00%
1350	BLERJA E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE (MË PAK SE 1000 EURO)	159,013.25	248,636.25	89,623.00	56.36%
13501	Mobiljet	50,289.34	15,000.00	-35,289.34	-70.17%
13503	Kompjuterët	37,387.23	46,739.27	9,352.04	25.01%
13505	Makinat fotokopjuese-multifunksionale	17,515.62	21,896.98	4,381.36	25.01%
13506	Pajisjet specialistike mjekësore	0.00	15,000.00	15,000.00	-
13509	Pajisjet e tjera	53,821.06	150,000.00	96,178.94	178.70%

1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHËRBIME	1,641,530.61	955,000.00	-686,530.61	-41.82%
13610	Furnizimet për zyrë	400,187.79	250,000.00	-150,187.79	-37.53%
13616	Furnizimi me artikuj bujqësor	0.00	250,000.00	250,000.00	-
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	665,515.81	200,000.00	-465,515.81	-69.95%
13630	Furnizime mjekësore	483,045.72	200,000.00	-283,045.72	-58.60%
13640	Furnizimet e pastrimit	66,673.72	50,000.00	-16,673.72	-25.01%
13650	Furnizim me veshmbathje	26,107.57	5,000.00	-21,107.57	-80.85%
13700	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE	844,007.12	916,001.82	71,994.70	8.53%
13710	Vaji	3,530.28	0.00	-3530.28	-100.00%
13720	Nafta për ngrohje qendrore	236,564.06	295,738.19	59,174.13	25.01%
13730	Vaji për ngrohje	4,046.24	0.00	-4,046.24	-100.00%
13760	Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	483,704.03	500,000.00	16,295.97	3.37%
13770	Derivate për gjeneratorë	17,246.78	0.00	-17,246.78	-100.00%
13780	Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	96,200.13	120,263.63	24,063.50	25.01%
13790	Gaz natyror	2715.6	0.00	-2715.6	-100.00%
1380	LLOGARITË E AVANCEVE (PARADHËNIES)	23,000.00	23,752.10	752.10	3.27%
13810	Avanc (paradhënia) për para të imëta	8,000.00	5,000.00	-3000	-37.50%
13820	Avanc (paradhënia) për udhëtime zyrtare	15,000.00	18,752.10	3,752.10	25.01%
1395	SHËRBIMET E REGJISTRIMIT DHE TË SIGURIMEVE	594,463.02	27,262.83	-567,200.19	-95.41%
13950	Regjistrimi i automjeteve	13,808.72	17,262.83	3,454.11	25.01%
13951	Sigurimi i automjeteve	21,944.76	10,000.00	-11,944.76	-54.43%
13953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	558,709.54	0.00	-558,709.54	-100.00%
1400	MIRËMBAJTJA	1,709,608.51	4,286,162.66	2,576,554.15	150.71%
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	59,648.15	60,000.00	351.85	0.59%
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave të banimit	143,090.77	0.00	-143,090.77	-100.00%
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	0.00	250,000.00	250,000.00	-

14023	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	169,725.00	1,100,000.00	930,275.00	548.11%
14024	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	76,036.80	150,000.00	73,963.20	97.27%
14026	Mirëmbajtja e objekteve sportive	0.00	50,000.00	50,000.00	-
14030	Mirëmbajtja e autorrugëve	79,402.64	120,000.00	40,597.36	51.13%
14032	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	950,460.00	1,199,623.14	249,163.14	26.22%
14040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe të komunikimit	41,832.05	52,295.92	10,463.87	25.01%
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	3,394.50	4,243.60	849.10023	25.01%
14060	Mirëmbajtja rutinore	186,018.60	1,300,000.00	1,113,981.40	598.85%
1410	QIRAJA	49,695.48	45,000.00	-4,695.48	-9.45%
14110	Qiraja për ndërtesa	34,759.68	30,000.00	-4,759.68	-13.69%
14140	Qiraja për makineri	14,935.80	15,000.00	64.20	0.43%
1420	SHPENZIMET E MARKETINGUT	118,888.97	0.00	-118,888.97	-100.00%
14210	Reklammat dhe konkurset	8,296.16	0.00	-8,296.16	-100.00%
14220	Botimet e publikimeve	6,110.10	0.00	-6,110.10	-100.00%
14230	Shpenzimet për informim publik	104,482.71	0.00	-104,482.71	-100.00%
1430	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT	13,170.66	40,000.00	26,829.34	203.71%
14310	Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	13,170.66	40,000.00	26,829.34	203.71%
1440	SHPENZIMET PËR VENDIMET E GJYKATAVE	49,126.56	0.00	-49,126.56	-100.00%
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	49,126.56	0.00	-49,126.56	-100.00%

Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale si kategori ekonomike kanë rritje prej 27.60% krahasuar me vitin 2024 edhe pse në këtë kategori shpenzimet po rriten vazhdimisht dhe Buxheti është i pamjaftueshëm për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	Buxheti Aktual 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%
13200	SHPENZIMET KOMUNALE	564,014.00	719,694.00	155,680.00	27.60%
1320	SHPENZIMET KOMUNALE	564,014.00	719,694.00	155,680.00	27.60%
13210	Energjia elektrike	485,214.00	665,218.90	180,004.90	37.10%
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	49,000.00	32,532.15	-16,467.85	-33.61%
13230	Mbeturinat	26,700.00	16,942.95	-9,757.05	-36.54%
13250	Telefonia fikse	3,100.00	5,000.00	1,900.00	61.29%

Subvencionet për vitin 2025 janë rritur për 1,100,000.00€ krahasuar me buxhet të vitit 2024, shprehur në përqindje është 116%. Në kuadër të kësaj kategorie të shpenzimeve do të kemi shpenzime të subvencioneve në bujqësi, dhe do të intervenojmë në raste më të arsyeshme duke parë nevojën për të shtuar mundësitë për zhvillim të kësaj dege të ekonomisë. Gjithashtu kemi subvencionet në kulturë, rini e sport, për të financuar dhe ndihmuar edhe më shumë këto lëmi përmes projekteve të prezantuara me arsyeshmëri nga përgjegjësitë e tyre të cilat padyshim se do të jenë në funksion të arritjes së sukseseve si në sport ashtu edhe në kulturë si dhe përkrahje të rinisë. Po ashtu në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, arsim me mbështetje studentëve me bursa si dhe në shërbime publike në intervenim në raste urgjente.

Kodi ekonomik	Kategoritë ekonomike	Buxheti aktual 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%
200	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	950,000.00	2,050,000.00	1,100,000.00	116%
2100	SUBVENCIONET	565,500.00	431,000.00	-134,500.00	-24%
21110	Subvencionet për entitetet publike	292,500.00	188,000.00	-104,500.00	-36%
21200	Subvencionet për entitetet jopublike	273,000.00	243,000.00	-30,000.00	-11%
2200	TRANSFERET	384,500.00	1,369,000.00	984,500.00	256%
22202	Transferet për përfitues individual tjerë	384,500.00	1,093,000.00	708,500.00	184%
22298	Pagesat për shërbimet e varrimit	0.00	276,000.00	276,000.00	-

2310	SUBVENCIONET PËR FERMERË	0.00	250,000.00	250,000.00	-
23110	Pagesat për sektorin e blegtorisë	0.00	150,000.00		-
23130	Pagesat për kulturat bujqësore	0.00	100,000.00		-

Shpenzimet kapitale - Buxheti i vitit 2025 do të ketë rritje të vlerës së kategorisë së investimeve kapitale të planifikuara të shpërndara në projekte kapitale. Vlera e investimeve kapitale ka shënuar rritje nga viti paraprak. Viti 2025 do të ketë vlerë më të rritur për shpenzime kapitale për 1,341,638.32 euro sesa viti 2024 apo në përqindje do të jenë për 12.21% më e lartë se viti 2024.

Kodi ekonomik	Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%
30000	Shpenzimet kapitale	10,987,196.00	12,328,834.32	1,341,638.32	12.21%
3110	NDËRTESTAT	1,910,000.00	1,750,000.00	(160,000.00)	-8.38%
31110	Ndërtesat e banimit	300,000.00	0.00	(300,000.00)	-100.00%
31120	Ndërtesat administrative dhe afariste	250,000.00	300,000.00	50,000.00	20.00%
31121	Ndërtesat arsimore	900,000.00	950,000.00	50,000.00	5.56%
31122	Ndërtesat shëndetësore	460,000.00	500,000.00	40,000.00	8.70%
3111	OBJEKTET	612,500.00	493,834.32	(118,665.68)	-19.37%
31123	Objektet kulturore	80,000.00	93,834.32	13,834.32	17.29%
31124	Objektet sportive	532,500.00	400,000.00	(132,500.00)	-24.88%
3112	STRUKTURAT TJERA	8,424,696.00	9,100,000.00	675,304.00	8.02%
31129	Fushat sportive	0.00	250,000.00	250,000.00	-
31230	Rrugët lokale	4,875,606.50	4,900,000.00	24,393.50	0.50%
31240	Trotuaret	450,000.00	500,000.00	50,000.00	11.11%
31250	Rrjetet e kanalizimit	1,158,167.50	1,200,000.00	41,832.50	3.61%
31260	Rrjetet e ujësjellësit	1,940,922.00	2,000,000.00	59,078.00	3.04%
31930	Deponitë e mbeturinave	0.00	100,000.00	100,000.00	-
33202	Shtretërit e lumenjve	0.00	150,000.00	150,000.00	-

3160	PAJISJET	40,000.00	110,000.00	70,000.00	175.00%
31660	Pajisje Speciale Mjekësore	0.00	100,000.00	100,000.00	-
31690	Pajisje tjera	40,000.00	10,000.00	(30,000.00)	-75.00%
3170	MJETET TRANSPORTUESE DHE MAKINERIA	0.00	75,000.00	75,000.00	-
31703	Veturat e Ndihmës së Shpejtë	0.00	75,000.00	75,000.00	-
3210	TOKAT, PARQET, PYJET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE	0.00	800,000.00	800,000.00	-
32140	Parqet dhe hapësirat publike	0.00	800,000.00	800,000.00	-

SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË PROGRAME BUXHETORE

Në këtë kapitull të projekt-buxhetit për vitin 2025 do të paraqesim shpërndarjen buxhetore në kategori ekonomike për secilin program buxhetor. Kjo shpërndarje do të bëhet kryesisht duke marrur për bazë kërkesat e zyrtarëve autorizues së buxhetit me miratim të Kryetarit të Komunës si dhe të organeve tjera. Si e tillë përmes dokumentit të projektbuxhetit do tu prezantohet anëtarëve të Kuvendit për miratim.

Pjesë e buxhetit 2025-2027 do të jenë padyshim edhe tabelat buxhetore të formatit unik të Ministrisë së Financave të cilat do të jenë më pas pjesë e Ligjit të Buxhetit për vitin 2025 të Republikës së Kosovës.

Tabelat buxhetore:

Tabela I- Të hyrave dhe shpenzimeve komunale;

Tabela II- Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal;

Tabela III- Plani i ndarjeve buxhetore;

Tabela IV- Plani Afatmesëm 2025-2027 për Investime Kapitale;

Tabela I- Të hyrat dhe shpenzimet komunale

Nr.	Përshkrimi	Viti 2024 Buxheti aktual	Planifikimi për Vitin 2025	Viti 2026 Vlerësimi	Viti 2027 Vlerësimi
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	41,184,014.00	46,013,006.00	48,311,501.00	50,686,423.00
1.1	Grantet qeveritare	35,774,286.00	38,038,700.00	39,758,259.00	41,541,509.00
1.3	Të hyrat vetanake	5,409,728.00	7,974,306.00	8,553,242.00	9,144,914.00
		41,184,014.00	46,013,006.00	48,311,501.00	50,686,423.00
2.1	Shpenzimet rrjedhëse	29,846,818.00	33,684,171.68	35,169,315.00	36,752,512.00
2.1.1	Pagat dhe shtesat	20,332,804.00	20,913,354.31	22,063,589.00	23,232,959.00
2.1.2	Mallrat dhe Shërbimet	8,000,000.00	10,001,123.37	10,201,146.00	10,405,169.00
2.1.3	Shpenzimet komunale	564,014.00	719,694.00	752,080.00	789,684.00
2.1.4	Subvencionet	950,000.00	2,050,000.00	2,152,500.00	2,324,700.00
2.2	Shpenzimet kapitale	11,337,196.00	12,328,834.32	13,142,186.00	13,933,911.00

TABELA II Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2025-2027

	Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2025 Plan	Viti 2026 Vlerësimi	Viti 2027 vlerësimi
1.1	TË HYRAT KOMUNALE-TOTALE	41,184,014.00	46,013,006.00	48,311,500.00	50,686,423.00
1.2	GRANTI QEVERITAR	35,774,286.00	38,038,700.00	39,758,258.00	41,541,509.00
1.1.3	TË HYRAT VETANAKE	5,409,728.00	7,974,306.00	8,553,242.00	9,144,914.00
1.1.1	Tatimi në pronë	3,228,367.00	2,946,970.00	3,274,540.00	3,602,276.00
	Taksat komunale	1,481,361.00	3,573,460.00	3,719,274.61	3,875,454.17
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	70,000.00	150,180.00	161,083.07	172,213.91
	Taksat e pajisjeve motorike	255,000.00	475,870.00	510,418.16	545,688.06
	Lejet për ndërtesa	691,361.00	2,000,000.00	2,031,581.41	2,071,141.38
	Matjet gjeodezike	185,000.00	372,690.00	399,747.29	427,369.83
	Taksat tjera komunale	60,000.00	150,440.00	161,361.94	172,512.05
	Taksat për legalizimin e pronës	220,000.00	424,280.00	455,082.73	486,528.94
1.1.2	Ngarkesat komunale	610,000.00	1,321,216.00	1,417,136.28	1,515,060.40
	Të hyrat nga qiraja	100,000.00	247,400.00	265,361.24	283,697.70
	Bashkë-pagesat për arsim	80,000.00	150,920.00	161,876.79	173,062.48
